



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 676/5 Prot.

Tiranë, më 12.07.2021

V E N D I M

Nr. 130, Datë 12.07.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 76, datë 26.04.2021, të K.K¹, kundër: Ambasadës Franceze në Tiranë dhe Shoqërisë ICTS “Albania Integrated Services” sh.p.k, me pretendimin e diskriminimit për shkak të gjinisë dhe denoncimit të ngacmimit/shqetësimit që ka pasur nga ana e një punonjësi të Ambasadës Franceze në Tiranë².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se:

Nga data 20.04.2016 deri në datë 29.09.2020 ka qenë me detyrë punonjëse shërbimi në ekipin e sigurisë tek Ambasada Franceze në Tiranë, dhe ka vazhduar marrëdhëniet kontraktuale me punëdhënësin ICTS, deri në datë 31.12.2020 kur i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Për shkaqe të pavarura nga ankuesja, ka rënë pre e diskriminimeve gjatë punës që kryente pranë Ambasadës Franceze dhe konkretisht nga eprori i drejtpërdrejtë, Th. G, me detyrë, shefi i sigurisë së ambasadës, pasi kundërshtonte në mënyrë të përsëritur sjelljet shqetësuese dhe me karakter seksual të ardhura nga ana e Th.G, dhe është bërë shënjestër kërcënimesh dhe diskriminimi, deri sa e kanë pushuar nga puna, pa asnjë paralajmërim paraprak. Ankuesja

¹ Plotësuar nga ankuesja në datë 29.04.2021.

² Referuar tek “çdo shkak tjetër”, sipas listës së shkaqeve të LMD-së.

deklaron se për sjelljet e Th. G ka vënë në dijeni I. S³, me detyrë përgjegjës/menaxher operacional. Ankuesja shprehet se punëdhënësi, ICTS nuk ka mbrojtur të drejtat e saja si punëmarrëse, lidhur me shqetësimet dhe diskriminimet që klienti (Ambasada) ushtronte ndaj saj, por është bërë palë me klientin duke mbështetur motive të pavërteta në lidhje me shkarkimin nga detyra në ambasadë. Punëdhënësi ICTS edhe pse kishte dijeni për ngacmimet e shefit të sigurisë, në asnjë moment nuk ka reaguar për të sqaruar situatat apo për të zgjidhur problematikat, por për ICTS ishte më e rëndësishme kontrata me klientin sesa mbrojtja e dinjitetit të punëmarrësve të saj. Me datë 29.09.2020, e kanë larguar nga detyra në Ambasadë, pa asnjë njoftim paraprak dhe i kanë propozuar një vend pune tjetër, për të njëjtin “pozicion”, por me pagë më të ulët dhe jashtë qytetit të Tiranës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Ambasadës Franceze/Tiranë dhe “ICTS Albania Integrated Services” sh.p.k, për shkaqet e pretenduara prej saj.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të gjinisë në formën e shqetësimit nga ana e Ambasadës Franceze⁴ në Tiranë.

Në kontekst të legjitimitetit të ankimimit kundrejt subjekteve ndaj të cilëve ankuesja ka pretenduar diskriminimin, Komisioneri vëren se, Ambasada Franceze/Tiranë, përfshihet tek subjektet që gëzojnë imunitet kundrejt proceseve administrative që mund të ndërmerren ndaj tyre nga vendi pritës. Në këtë kuadër nuk mund t’i nënshtrohet hetimit administrativ pranë KMD-së.

³ Referuar procesverbalit datë 29.04.2021, K.K deklaron se ka vënë në dijeni I.S, nëpërmjet bisedës në celular dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

⁴ Th. G, punonjësi i Ambasadës Franceze/Tiranë, në detyrën e Shefit të Sigurisë Operacionale të Ambasadës.

Kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, lidhur me sa më sipër, parashikon si më poshtë:

Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: “Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: “a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.

Neni 122 i Kushtetutës përcakton se: “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë. 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

Konventa e Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”(Konventa) ka hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998. Neni 31 i Konventës ka përcaktuar se: “1. Agjenti diplomatik gëzon imunitetin e juridiksionit penal të Shtetit pritës. Ai gëzon gjithashtu imunitetin e juridiksionit të tij civil dhe administrativ, përveç kur bëhet fjalë: a) për një veprim real lidhur me një ndërtesë private që ndodhet në territorin e Shtetit pritës, përveç kur agjenti diplomatik e posedon atë për llogari të Shtetit akreditues për qëllimet e misionit. b) për një veprim lidhur me një trashëgimi në të cilin agjenti diplomatik figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar ose legatar, si privat dhe jo në emër të Shtetit akreditues. c) për një veprim lidhur me një profesion të lirë ose me një aktivitet tregtar çfarëdo qoftë, të ushtruar nga agjenti diplomatik në Shtetin pritës jashtë funksioneve të tij zyrtare. 2. Agjenti diplomatik nuk është i detyruar të japë dëshminë e tij. 3. Asnjë masë zbatimi nuk mund të merret karshi agjentit diplomatik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat a), b) dhe c) të paragrafit të parë të këtij neni, dhe me kusht që zbatimi të kryhet pa cenuar paprekshmërinë e personit të tij ose të banesës së tij”.

Aktet ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar, të tilla si Karta e OKB-së dhe Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (e vitit 1961, hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998), Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore (1963), Konventa për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjensive të Specializuara dhe anekset e saj, si dhe marrëveshjet dy palëshe të ndryshme të lidhura me shtetit Shqiptar dhe shteteve të tjera, përcaktojnë rrethin e subjekteve që janë të përjashtuar nga juridiksioni territorial i brendshëm gjyqësor dhe administrativ dhe, si pasojë, nuk mund të jenë subjekte të padive, kërtimeve apo procedurave të ekzekutimit në vendin tonë. Përjashtimi nga

juridiksioni territorial i vendit pritës, Shqipërisë, përfshin të gjitha funksionet zyrtare të këtyre subjekteve dhe është i paprekshëm⁵.

Marrëveshjet ndërkombëtare sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 116), kanë një status superior ndaj ligjeve. Ligji shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë njohin dhe pranojnë mungesën e juridiksionit të gjykatave shqiptare, për shkak të imunitetit që gëzon njëra prej palëve në mosmarrëveshje si subjekt i posaçëm parashikuar në një marrëveshje/konvente dy ose shumëpalëshe.

Bazuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, evidentohet se e drejta e aksesit në gjykatën kombëtare i'u nënshtrohet rregullimeve kufizuese për aq sa këto kufizime nuk reduktojnë aksesin e individit në gjykatat kombëtare në një mënyrë të tillë, apo në atë masë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës. Dhënia e imunitetit palës së paditur në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe legjislacionit në fuqi nuk mund të thuhet se tejkalon marzhin e vlerësimit që shtetit shqiptar i lejohet në kufizimin e aksesit të individit në gjykatë. Kjo bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, sipas së cilës “... disa kufizime mbi aksesin (në gjykatë) duhet të konsiderohen si të qënësishme, si për shembull ato kufizime që përgjithësisht pranohen nga komuniteti i shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror⁶”.

Në një rast të ngjashëm, për përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njehsues se, kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, sipas Marrëveshjes Dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.06.1992, janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, pavarësisht nga ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga këto marrëdhënie, përveç rasteve kur është pranuar juridiksioni i gjykatave shqiptare vullnetarisht⁷.

Anëtarët e përfaqësive diplomatike nuk janë nën juridiksionin gjyqësor shqiptar, vetëm nëse ata e pranojnë këtë me vullnetin e tyre. Ky përjashtim nga juridiksioni shqiptar është i parashikuar në nenin 39 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet juridiksioni ndaj përfaqësuesve diplomatik e konsullorë: “Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare. Ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike””.

⁵ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011.

⁶ MvElhinney kundër Irlandës [GC], nr.31253/96, § 37, ECHR 2001-XI; Manolescu dhe Dobrescu, (dec.), nr.60861/00, § 80, ECHR 2005-VI; Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë (dec.), nr.26937/04, ECHR 2006; Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë nr.35720/04 dhe 42832/06, § 44-47 ECHR 2009.

⁷ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011

Sa më sipër, konform nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenit 3 të Ligjit nr. 9105, datë 17.07.2003, “Për Aderimin e Shqipërisë në Konventën Për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara dhe Anekset e saj”, konstatohet dhe pranohet mungesa e juridiksionit gjyqësor. Gjykatat janë institucionet pranë të cilave mund të kundërshtohen aktet administrative të organeve të administratës shtetërore, ndër të cilat edhe vendimmarrja e KMD-së.

Po ashtu, neni 31/1 i Konventës së Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”, ka përcaktuar qartë gëzimin e imunitetit të agjentit diplomatik edhe përsa i takon juridiksionit administrativ.

Në këtë kontekst, Komisioneri, konstaton mungesën e juridiksionit administrativ dhe kompetencës mbi subjektin e Ambasadës, për sa kohë edhe vetë gjykata, ka pranuar mungesën e juridiksionit gjyqësor lidhur me shqyrtimin e çështjeve me palë ambasadat e huaja në territorin e Shqipërisë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 676/2, datë 11.05.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Shoqërinë ICTS “Albania Integrated Services”, shpk dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion, si më poshtë vijon:
 - Informacion të përgjithshëm mbi pretendimet e ankueses.
 - Informacion mbi veprimet e ndërmara nga ana e ICTS-së, pasi është vënë në dijeni të veprimeve shqetësuese/ngacmuese ndaj punonjësës, K.K.
 - Kopje të plotë të procedurës së ndjekur për përfundimin e marrëdhënies së punës me K.K.
 - Kopje të të gjithë masave disiplinore të dhëna ndaj ankueses, kundërshtimeve të saj dhe përgjigjeve të dhëna nga punëdhënësi.
 - Kopje të Kontratës së Punës së ankueses.
 - Kopje të Librezës së Punës së ankueses.
 - Kopje të vlerësimit të punës së ankueses për vitet: 2018, 2019 dhe 2020.
 - Informacion për punonjës të tjerë që janë transferuar pas kërkesës së ambasadës apo klientëve të tjerë, gjatë viteve 2019-2020.
 - Kopje të Rregullores së Brendëshme dhe Kodit të Etikës të shoqërisë.
 - Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, një kopje të akteve.

Me shkresën nr. 50/21, datë 17.05.2021, Kompania “ICTS Albania Integrated Services”, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “K.K, në datë 20.04.2016 ka nënshkruar Kontratën e punësimit me Kompaninë ICTS, në pozicionin si Punonjëse Shërbimi Sigurie. Neni 12.3 i Kontratës

citon se, punëdhënësi mundet ta zgjidhë atë në qoftë se i kërkohet nga Ambasada Franceze. Në datë 25.03.2020, ish-punonjësja ka marrë vërejtje me shkrim për shkak të moszbatimit të procedurave dhe rregullave të shërbimit të Sigurisë në Ambasadën Franceze dhe në vijim performanca e saj është mbikqyrur në mënyrë që të mos çenohej Siguria e Ambasadës. Në vijim, për shkak të mungesës së motivimit në punë (pakënaqësi për kryerjen e turneve të treta), mungesës së komunikimit profesional në ambientin e punës dhe mungesës së besueshmërisë, Klienti “Ambasada Franceze”, bazuar dhe në marrëveshjen e bashkëpunimit që kishte me Kompaninë ICTS, konkretisht neni 5 i marrëveshjes, ka dërguar një kërkesë me shkrim në datë 28.09.2020, për zëvendësimin e menjëhershëm të kësaj punonjëseje. Në vijim të kërkesës me shkrim nga Ambasada, e cila nuk dëshironte më që K.K të vazhdonte të ishte pjesë e stafit të Shërbimit të Sigurisë në Ambasadën Franceze, duke filluar nga data 30.09.2020, ICTS, nuk procedoi me zgjidhje të menjëhershme të marrëdhënies së punës, por mori në konsideratë gjendjen e papritur në të cilën do të ndodhej punonjësja, pas atij vendimi, dhe me dëshirën e mirë për ta ndihmuar, i ka ofruar një tjetër pozicion të ngjashëm pune: “Punonjës Shërbimi” pranë Stacionit Tirana Business Park, ku i është parashtruar dhe oferta e detajuar e punës. ICTS i ka komunikuar kërkesën punonjëses për zëvendësimin e saj, me datë 29.09.2020, menjëherë pas përfundimit të turnit në Ambasadë dhe i ka parashtruar vendin e ri të punës. Për këtë qëllim është mbajtur dhe procesverbali i takimit, me nr. 105/20. ICTS hedh poshtë pretendimin e ish-punonjësës se për sjelljet e Th. G sipas saj, ajo ka vënë në dijeni menaxherin e stacionit I. S apo përfaqësues të tjerë të punëdhënësit nuk kanë qenë në asnjë moment të informuar rreth kësaj teme, madje I. S është i gatshëm të deklarojë, dhe të verë në dispozicion telefonin e tij apo tabulatet telefonike për të vërtetuar këtë gjë. Gjithashtu, është absurd dhe fakti që pavarësisht se punonjësja ndihej e diskriminuar në vendin e punës, kur u gjend përpara një vendimi të tillë nga Ambasada Franceze, K.K bëri të gjitha përpjekjet e mundshme për tu rikthyer në Ambasadë duke i shkruar në mënyrë të drejtpërdrejtë zv. Ambasadores në Ambasadën Franceze, Inspektoriatit të Punës si dhe Ministrisë Franceze të Punëve të Jashtme, pikërisht me synimin për t'u kthyer në vendin e punës. Duke qenë se K.K, nuk ishte më pjesë e stafit të Ambasadës që prej datës 30.09.2020 dhe e kishte të ndaluar të hynte në Ambasadën Franceze, punëdhënësi ICTS, i ofroi pa asnjë hezitim dhe i mundësoi ambientet e veta për tu takuar me zv. Ambasadoren. N. C, e cila dëgjoi gjithë pretendimet e saj dhe i komunikoi se vendimi i marrë për zëvendësimin e K.K nga Ambasada Franceze nuk ishte personal i Th. G, por ishte vendim i një komisioni të tërë në Ambasadë, mbështetur në performancën e ish-punonjësës. Gjithashtu, informohet se Klienti “Ambasada Franceze”, i ka dërguar edhe më parë shoqërisë ICTS një kërkesë të tillë të ngjashme për një ish-punonjës të gjinisë mashkullore, kjo për të vërtetuar se është e drejtë e Klientit, mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit, ku për arsye specifike të mirëcituara, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për çdo punonjës që kërkon të zëvendësojë bazuar në performancën e tij/saj. Lidhur me procedurën e ndjekur nga ana e ICTS-së për përfundimin e marrëdhënies së punës me K.K, ju informojmë si më poshtë: - Në datë 29.09.2020, Menaxherja e Burimeve Njerëzore të ICTS, pasi i komunikoi vendimin e Klientit “Ambasada Franceze” K.K, i pasqyroi dhe ofertën e detajuar të punës ku specifikohet se punëdhënësi mbetet në pritje të vendimit nga ana e ish-punonjësës, brenda datës 06.10.2020. Në procesverbalin e takimit, ish-punonjësja ka

shkruar se: “i duhej kohë të mendohet në lidhje me ofertën e re”. Në vijim të ofertës së punës së ofruar, është mbajtur dhe procesverbali me nr. 116/20, për takimin e datës 06.10.2020 ku ish-punonjësja sërish është shprehur se, në lidhje me ofertën e punës “nuk mund të jap një përgjigje pasi i duhet të konsultohet”. Me anë të shkresës me nr. 117/1, datë 07.10.2020, ICTS i ka kthyer përgjigje shkresës dhe e-mailit të datës 06.10.2020, të dërguar nga K.K dhe i citon se është në pritje të vendimit në lidhje me pranimin ose jo të ofertës së punës të ofruar, deri në datë 12.10.2020. Nga ana e K.K nuk ka patur ndonjë reagim dhe me shkresën nr. 117/2, datë 13.10.2020, ICTS i ka dërguar një letër tjetër për konfirmimin ose jo të ofertës së re të punës. Në datën 16.10.2020 i është dërguar dhe shkresa nr. 121/20, ku punëdhënësi, bazuar dhe në përcaktimet e neneve 144/1 dhe 144/2, e ka ftuar në një takim tjetër në datë 21.10.2020, për të diskutuar mbi marrëdhëniet e punësimit, dhe me datë 21.10.2020 është mbajtur nga ICTS dhe procesverbali nr. 121/1, në mungesë të K.K. Me shkresën nr. 123/20, K.K i është dërguar një njoftim i dytë i përsëritur ku punëdhënësi e fton për një takim në datën 26.10.2020, ku po në atë datë është mbajtur dhe procesverbali nr. 123/1, në mungesë të K.K. Të ndodhur përpara mosreagimit të saj si punëmarrëse, ICTS përgatiti shkresën “Njoftim përfundimtar për zgjidhjen e Kontratës së Punës”, me nr. 125/20, datë 29.10.2020, datë e cila korrespondonte me datën e takimit që K.K kishte me përfaqësuesen e Ambasadës Franceze, N. C në zyrën e ICTS-së. Këtë shkresë K.K e firmosi personalisht duke u informuar se në zbatim të nenit 143 të Kodit të Punës, Kontrata e punës në fuqi do të përfundonte në datë 31.12.2020, duke u respektuar afati 2 mujor i njoftimit por dhe përcaktimi i pikës 3 të nenit 143. Pra, në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se në adresën ku vetë ish-punonjësja kishte kërkuar t'i dërgonim shkresa, ICTS i ka dërguar disa shkresa, konkretisht me datë 13.10.2020, datë 16.10.2020, 21.10.2020, nëpërmjet të cilave lutej të paraqitej në takim me punëdhënësin, të vlerësonte propozimin e ofertës së punës, por gjithmonë jemi ndodhur përpara mosreagimit të K.K, pavarësisht se të gjitha njoftimet janë marrë rregullisht nga ankuesja, në adresën e deklaruar. Gjithashtu vlen të përmendim dhe faktin që në Kontratën e punësimit të saj, Neni 4.1 citohet se vendi fillestar i punës është në Ambasadën Franceze ose/dhe në ambientet e tjera të caktuara nga Punëdhënësi, detyrim kontraktual i cili nuk është plotësuar nga K.K. Lidhur me pretendimin e ankueses për shkak të gjinisë, ju sqarojmë se pranë këtij objekti shërbimi ofrojnë shërbimin e sigurisë gjithsej 5 femra dhe 3 meshkuj të tjerë dhe asnjë prej tyre nuk ka parashtruar ndonjëherë, përgjatë 5 viteve të shërbimit pranë ICTS ndonjë indicie apo pretendim të çfarëdolloji për ngacmim apo diskriminim, përfshirë këtu dhe K.K, ku hera e parë që e ka përmendur një argument të tillë ka qenë në momentin që i është komunikuar kërkesa e Ambasadës Franceze për të mos qenë më pjesë e stafit të Sigurisë, pra me datë 29.09.2020. Lidhur me pretendimin se ICTS i ka ofruar një vend tjetër pune me pagë më të ulët, jashtë Tiranës, sqarohet se, ICTS nuk ka Kontratë Bashkëpunimi me ndonjë ambasadë tjetër të cilës i ofron shërbim sigurie apo objekt tjetër shërbimi brenda në qytetin e Tiranës. Oferta e propozuar ndaj K.K ka qenë në një subjekt tjetër, konkretisht pranë Tirana Business Park (TSP), në Fushë Prezë, ku transporti në këtë vend pune mbulohet nga ICTS. Të gjitha stacionet e tjera ku ICTS ofron Siguri, përfshirë TBP, kanë një nivel më të ulët page sesa niveli i pagave në Ambasadë dhe fakti që

ICTS ka ofruar një vend tjetër pune me pagë më të ulët krahasuar me Ambasadën ka qenë duke ju përshtatur vështirësisë së pozicionit të ri të punës me nivelin e pagave në atë pikë shërbimi, gjithmonë në përputhje me parashikimin e Ligjit 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, i ndryshuar, Neni 18, pika g), ku përcaktohet se, “paga bazë është 50 % më e madhe se paga minimale”. ICTS e ka patur të pamundur të vijonte t’i ofronte të njëjtin nivel page si në Ambasadë, kjo për shkaqe financiare por edhe për të mos diskriminuar punonjësit e tjerë që operojnë në stacionet e tjera të shërbimit, në mënyrë që të ruante parimin e barazisë që, për punë të njëjtë pagesa mes punonjesve të jetë e njëjtë. Në asnjë rast K.K nuk ka pasur pretendime lidhur me pagën por ka shprehur se ajo dëshiron të punojë vetëm në Ambasadën Franceze duke qenë se për këtë arsye kishte pranuar të punësohej në ICTS, në vitin 2016, referuar kjo edhe komenteve të saj pasqyruar në Procesverbalin e datës 29.10.2020 e në komunikimet e tjera në vijim. Theksojmë se Ambasada Franceze ka kaluar disa herë në nivel më të lartë risku për shkak të sulmeve terroriste të ndodhura në Francë që shpjegon dhe faktin pse punonjësit që operojnë në ambasadë kanë dhe pagesë më të lartë së punonjësit në stacione të tjera ku ICTS operon. Edhe marrja në punë e K.K në vitin 2016 është bërë me konfirmimin e Ambasadës Franceze pasi sipas kushteve të kontratës së shërbimit, ICTS nuk mund të punësojë asnjë kandidat apo të largojë nga puna asnjë punonjës pa aprovimin paraprak të përfaqësuesit të Ambasadës, sipas Neni 3 të paragrafit II-Detyrimet e Titullarit”.

Në përgjigje të shkresës së Kompanisë “ICTS Albania Integrated Services”, ankuesja në datë 31.05.2021 në mes të tjerash ka deklaruar⁸ se: *“Lidhur me vërejtjen e datës 25.03.2020, masë e marrë vetëm ndaj ankueses, për një patrullim më pak se norma ditore, pra 10/11 patrullime për 8 orë shërbim, mesatarisht ka patrulluar çdo 48 minuta. Vërejtja dhe mbikqyrja për cënimin e sigurisë së ambasadës do të ishin me vend nëse ky rast përsëritej në mënyrë të shpeshtë dhe pas këshillimeve. Ankuesja informon se ish kolegët e saj, i kanë patur të përsëritura disa herë patrullimet e pakta dhe asnjë masë nuk është marrë ndaj tyre lidhur me patrullimet. Ndërkohë për motivet e përmendura tek procesverbali i largimit, “mungesa e motivacionit, e komunikimit joprofesional dhe pakënaqësia e turneve të treta, apo humbja e besueshmërisë”, ndaj K.K nuk rezulton asnjë vërejtje me shkrim apo verbale. ICTS në asnjë moment nuk rezulton që të ketë kërkuar një shpjegim apo mundësi të dytë tek klienti, lidhur me shkaqet e pretenduara ndaj saj. Ankuesja i mbetet qëndrimit, se largimi i saj ishte planifikuar nga të dyja palët që më herët, me largimin e I. G, ish-zëvendës ambasadore, e cila ishte pengesë e Th. G për planet e tija dashakeqe. Lidhur me deklaratimet e I. S, do të ishte habi të dëshmonte në disavantazh të kompanisë ku punon, pasi bisedat janë bërë verbalisht, kur ai vinte për kontroll apo kur sillte librat e planizimit të shërbimit, në ambasadë. Lidhur me pretendimin e kompanisë ICTS se ankuesja i ka shkaktuar dëm imazhi tek klienti, sepse ICTS nuk ka ofruar staf me integritet profesional, ankuesja informon se, ka qenë ambasada që e ka orientuar për procedurë tek ICTS-ja dhe jo anasjelltas dhe është përzgjedhur me intervistë nga Ambasada”.*

⁸ Referuar e-mail-it të dërguar në datë 31.05.2021.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankueses.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga ankuesja.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

K.K ka lidhur marrëdhëniet e punës me Kompaninë “ICTS Albania Integrated Services” shpk, me datë 20.04.2016, marrëdhënie e cila ka zgjatur deri me datë 31.12.2020. Bazuar në kontratën individuale të punës të ankueses, rezulton se ajo ka mbajtur pozicionin e punës si “Punonjëse Shërbimi në fushën e Sigurisë” për ICTS-së, pranë Ambasadës së Francës në Shqipëri dhe kontrata është nënshkruar fillimisht për një periudhë prove 3 (tre) mujore dhe më pas në datë 20.07.2016, është nënshkruar kontrata mes palëve me afat të pacaktuar.

Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga palët në proces, rezulton që marrëdhënia e punës mes palëve ka përfunduar “de facto” me datë 30.09.2020, ndërsa “de jure” në datë 31.12.2020.

Me shkresën datë 28.09.2020 drejtuar ICTS-së, Ambasada Franceze ka kërkuar që në mbështetje të nenit nr. 5 të marrëveshjes së sigurisë mes palëve, të bëhet zëvendësimi i dy punonjëseve: E.Z dhe K.K, me arsye kryesore: mungesa e motivimit në punë, mosperformimi sipas procedurave, mungesa e komunikimit profesional në vendin e punës, mungesa e besueshmërisë dhe gjithashtu për K.K, se nuk dëshiron të punonjë gjatë turnit të III-të.

Në datë 29.09.2020 mes Kompanisë ICTS dhe ankueses është mbajtur procesverbali i takimit në vijim të kërkesës së ardhur nga klienti (Ambasada Franceze) kundrejt punonjëses K.K, të cilët nuk dëshironin që punonjësja të ishte pjesë e stafit, duke filluar nga data 30.09.2020. Në këtë procesverbal, ICTS i ka ofruar punonjëses K.K një pozicion të ngjashëm “Punonjëse Shërbimi” pranë Tirana Business Park, duke filluar nga dita e nesërme, datë 30.09.2020. K.K ka kundërshtuar arsyet e kërkesës për zëvendësimin e saj duke deklaruar se nuk ka pasur asnjë ankesë nga ana e saj për turnin e tretë dhe nuk ka pasur probleme të komunikimit gjatë orarit të punës, gjithashtu ka theksuar se mosvlerësimi i punës së saj nuk ka ndodhur nga ana profesionale por personale. Lidhur me ofertën e punës, ankuesja ka deklaruar se nuk pranon sepse ka aplikuar për pozicionin pranë Ambasadës Franceze dhe se i duhet kohë në lidhje me ofertën e bërë.

Në datë 06.10.2020 mes palëve ICTS dhe ankueses është mbajtur procesverbali i takimit në vijim të ofertës së punës së ofruar ankueses, e cila është përgjigjur se nuk mund të japë një përgjigje, pasi i duhet të konsultohet.

Më pas nga ana e ICTS-së me shkresat datë 13.10.2020 “Kërkesë për konfirmim në lidhje me ofertën e punës së ofruar”, datë 16.10.2020 “Njoftim për zhvillimin e një takimi për të diskutuar për zgjidhjen e kontratës së punës”, datë 21.10.2020 “Njoftim për zhvillimin e një takimi të dytë për të diskutuar për zgjidhjen e kontratës së punës” dhe datë 29.10.2020 “Njoftim përfundimtar për zgjidhjen e kontratës së punës”, është njoftuar K.K lidhur me pranimin ose jo të ofertës së punës pranë TBP-së, dhe në përfundim pasi nuk ka pasur një përgjigje nga ana e saj, ICTS e ka njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në datë 31.12.2020. Subjekti ankues ka marrë dijeni për këto shkresa, pasi i ka sjellë si dokumente shoqëruese bashkëlidhur ankesës së bërë pranë KMD-së, si dhe nuk ka kundërshtuar pranë Komisionerit, punëdhënësit (ICTS) apo në gjykatë procedurën dhe afatet e zgjidhjes së kontratës së punës⁹.

Në nenin nr. 5 të Marrëveshjes së lidhur mes Kompanisë ICTS dhe Ambasadës Franceze citohet¹⁰ se: “Në rast mospërmbushje të detyrimeve të titullarit nga ana e njërit prej punonjësve, Ambasada ka të drejtën të kërkojë zëvendësimin e tij, pa qenë e nevojshme të rritet çmimi i parashikuar në kontratë. Zëvendësimi duhet të bëhet brenda 48 orëve pas dorëzimit të kërkesës me shkrim”.

⁹ Referuar shkresës nr. 50/21, datë 17.05.2021 të ICTS-së, në të cilën shkruhet se në dijenin e tyre nuk ka ende ndonjë procedim gjyqësor ndaj ICTS dhe as kundrejt Ambasadës Franceze.

¹⁰ Referuar shkresës nr. 117/1, datë 07.10.2020 të ICTS drejtuar ankueses.

Referuar kontratës individuale të punës së ankueses, Komisioneri vëren se, bazuar në nenin 4, pika 1 dhe 2, përcaktohet se: *“1. Vendi fillestar i punës është në Ambasadën e Francës në Shqipëri ose/dhe në ambientet e tjera të Punëdhënësit. 2. Punëdhënësi ka të drejtë të transferojë Punëmarrësin, sipas diskrecionit të tij të plotë, të punonjë në çdo vend tjetër brenda territorit të Shqipërisë, kudo ku është e nevojshme për plotësimin e nevojave të Punëdhënësit pa pagesë shtesë.....”*, ndërsa në nenin 12.3 *“Zgjidhja e kontratës”* ka përcaktuar se: *“Punëdhënësi mund të zgjidhë kontratën pa njoftim ose pagesë në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë kontratë, si dhe në rast se konstatohet se punëmarrësi ka kryer, por pa u kufizuar në to, një nga shkeljet e poshtëshënuara;.....si dhe për çdo rast tjetër që mund të vlerësohet se përbën shkak për zgjidhjen e kontratës”*.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, rezulton se Ambasada Franceze me shkresën datë 28.09.2020 ka kërkuar nga Kompania ICTS zëvendësimin e punonjësës së sigurisë K.K, bazuar në nenin 5 të marrëveshjes së sigurisë dhe bazuar në këtë marrëveshje, ICTS-ja ka qenë e detyruar që brenda një afati prej 48 orësh të plotësonte këtë kërkesë. Bazuar në kontratën individuale të punës, rezulton se ankuesja ka qenë në dijeni se punëdhënësi mund të zgjidhte kontratën e punës me ankuesen ose mund ta transferonte atë pa pagesë shtesë.

Punëdhënësi ICTS, ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe në rastin e kërkesës datë 12.01.2021, të Ambasadës Franceze, kur ka kërkuar zëvendësimin e punonjësit L.Sh për arsye të mungesës së motivimit, mosperformimi sipas procedurave dhe mosrespektim të hierarkisë.

Lidhur me pretendimin e ankueses, se ka vënë në dijeni menaxherin e stacionit, I. S lidhur me ngacmimet dhe shqetësimet e ardhura asaj nga ana e punonjësit të Ambasadës Franceze, rezulton i pabazuar në fakte dhe prova, por mbetet thjesh deklarativ, për sa kohë nuk është depozituar asnjë dokument mbi bazën e të cilit të mund të evidentohet se punëdhënësi ICTS ka qenë në dijeni të ngacmimeve dhe shqetësimeve të bëra ndaj ankueses nga ana e punonjësit të ambasadës.

Referuar kontratës së punës së ankueses por dhe dokumentacionit të depozituar nga palët në proces, nuk rezulton që ankuesja të jetë ankuar apo të ketë ngritur shqetësime tek punëdhënësi, ICTS, lidhur me sjelljen e punonjësit të ambasadës Th. G.

Gjithashtu, referuar dokumentacioni të shqyrtuar, rezulton se ankuesja ka bërë të ditur faktin e sjelljes së Th. G ndaj saj, Këshilltares së Parë së Ambasadës Franceze¹¹ me e-mail-in datë 06.10.2020 dhe më pas me e-mail-in datë 19.10.2020 drejtuar Ministrisë së Jashtme të Francës, në të cilat ka shpjeguar situatën duke theksuar aktet dashakeq të Th. G ndaj saj dhe në asnjë rast nuk ka denoncuar apo përmendur sjelljet apo veprimet e punëdhënësit ICTS ndaj saj, për shkak të gjinisë.

Referuar dokumentacionit të depozituar, ankuesja ka dhënë informacion dhe shpjegime lidhur me ngacmimet dhe veprimet e bëra ndaj saj nga ana e punonjësit të ambasadës, për shkak të

¹¹ Në pozicionin si Këshilltare e Parë dhe Oficere e Sigurisë së Ambasadës Franceze.

gjinisë por në asnjë rast nuk ka sjellë asnjë provë dhe rrethanore për të provuar faktin se ka vënë në dijeni apo ka kërkuar ndihmë nga punëdhënësi për veprimet e punonjësit të ambasadës.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri konstaton se, subjekti ankues nuk ka arritur të provojë dhe të krijojë bindjen përpara KMD, se punëdhënësi ka qenë në dijeni të veprimeve të punonjësit të ambasadës dhe si rezultat i këtyre veprimeve ti jetë imponuar të punojë në një ambient pune frikësues, fyes dhe degradues.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Shoqërisë ICTS “Albania Integrated Services” sh.p.k.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë ICTS “Albania Integrated Services” sh.p.k, për shkakun e pretenduar nga subjekti ankues.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi diskriminues për shkak të gjinisë së saj, nga ana e Kompanisë ICTS.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në, nenin 1, 3, pika 1, nenin 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Mospranimin e pretendimit të paraqitur nga znj. K.K kundër Ambasadës Franceze në Tiranë, lidhur me pretendimin e diskriminimit për shkak të gjinisë në formën e shqetësimit seksual, për shkak se është e papajtueshme me parashikimet ligjore të nenit 31, të Konventës së Vjenës “*Për Marrëdhëniet Diplomatike*”, nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të K.K, për shkak të gjinisë, nga ana e Shoqërisë ICTS “Albania Integrated Services” sh.p.k.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA